213. **vak** (ngroh) *տաք* (tak, dak) = i nxehtë, i ngrohtë
214. **vakët** (i, e) (i ngrohtë, jo i nxehtë) *տաք* (tak, dak) = i nxehtë, i ngrohtë
215. **var** (me vendos, me var) *վար* (var) = poshtë; nën
216. **varfër** (i,e vorfën, vobegët) *որբ* (vorb, vorp) = jetim; i lënë në mëshirë të fatit
217. **vend** *վայր* (vajr) = vend; zonë; krahinë; poshtë, tokë
218. **ver** (me vendos në, mbi) *վեր* (var) = sipër; mbi
219. **vobegët** (i,e vorfën, varfër) *որբ* (vorb, vorp) = jetim  
i lënë në mëshirë të fatit
220. **xhagajdur** \* (F.GJ.SH.) *ճակատ տուր* (çakat tur, xhagad dur)  
= trego ballin, jepi ballin
221. **yll** (hyll, hyjni) *հուրի* (huri, hyri) = bukuroshe, hyri, peri

222. **zbardh** (zbardhoj) *սպիտակել* (spitakel, sbidagel) = zbardh, zbardhoj; agoj
223. **zemër** (shpirt) *սիրտ* (sirt, sird) = zemër; shpirt
224. **zemëroj** *զայրանալ* (zajrana'l) = zemërohem, nxehem, inatosem
225. **zhavorr** (zhur) *ժայռ* (zhajrr) = shkëmb
226. **zheg** (vapë, nxehtësi) *շոգ* (shog, shok) = zheg, vapë, nxehtësi
227. **zhur** (shur) *ժայռ* (zhajrr) = shkëmb
228. **zhur** (shur) *փշուր* (pshur) = thërriime
229. **zift** (serrë) *սեւ* (sev) = i, e zezë

## BERZH PIRANJANI

B. FJALË TË GJUHËS SHQIPE TË NGJASHME ME ATO TË GJUHËS  
ARMENE, TË GJUHËS TURKE, PERSE APO EDHE ARABE

(trajtuar nga Berzh Piranjani)

Shqip	Armenisht
1. <b>agon</b> - ( <i>Turqisht – ag = bardhë</i> )	<b>uł</b> (ak, ag) = burim, fillim; gur i çmuar
2. <b>azat</b> (i lirë, i lëshuar (frerësh) - ( <i>Turqisht – azát &lt; pers. – azad</i> )	<b>uquun</b> (azat, azad) = i lirë, i lëshuar (frerësh)
3. <b>azgan</b> (trim, i fuqishëm, vigan) - ( <i>Turqisht – azgân</i> )	<b>uqqulwû</b> (azgakan, azkagan) = farefis, i afër; soj, sojli, i fisëm
4. <b>babagysh</b> - ( <i>Turqisht – babá</i> )	<b>uuy</b> (pap, bab) = gjysh, babagysh
5. <b>bamje</b> - ( <i>Turqisht – bamyá</i> )	<b>pułhu</b> (bamia, pamia) = bamje

6. **çiban** *չիբան* (çiban, çipan) – çiban  
- (Turqisht – *çibán*)
7. **çoban** *չոբան* (çoban, çopan) – çoban  
- (Turqisht – *çobán* < Pers. - *çubán, shāban*)
8. **dadë** (nanë - F.GJ.SH.) *ուսւս* (tat, dad) = gjyshe, nanë  
- (Turqisht – *dadi*; Pers. - *dada*)
9. **dado** (kujdestare fëmijësh) *ուսւս* (tat, dad) = gjyshe  
- (Turqisht – *dadi*; Pers. - *dada*)
10. **dori'** (kalë qimekuq) *զորի* (xhori, çori) = mushkë  
- (Turqisht – *dorú*)
11. **dudë** (man i zi) *թութ* (tut) = man  
- (Turqisht – *dut*; Pers. – *tud*; arab - *tut*)
12. **dyshek** *դոշակ* (doshak, toshag) – dyshek  
- (Turqisht – *döşek*)
13. **gajret** (kurajë, durim, qëndrueshmëri) *գայրէ* (kaju'n, gaju'n) = i qëndrueshëm, i fortë  
- (Turqisht – *gayrét*)
14. **gjoks** (gji) *կուրծք* (kurck, gurck) = gjoks, gji  
- (Turqisht – *göğüs*)
15. **govatë** *գավաթ* (gavat, kavat) = kupë, gotë  
- (Turqisht – *kavatá, kuvata*)
16. **hiç** (asgjë) *ոչինչ* (voçinç) = hiç, asgjë;  
*ոչ* (voç) = jo, hiç, asgjë  
- (Turqisht < pers. - *hiç*)
17. **hoshaf\*** (F.GJ.SH) *խոշափ* (k<sup>h</sup>oshab, k<sup>h</sup>oshap) = hoshaf  
- (Turqisht – *hosáf*; pers. – *khosh áb*)

18. **hyri** (bukuroshe, peri)      **hуrуh** (huri, hyri) = bukuroshe,  
hyri, peri  
- (*Turqisht huri* < arab. - *hur*)
19. **jaran** (dashnor-e)      **jar** (jar) = dashnor-e  
- (*Turqisht - yaran*; pers. - *jar*)
20. **jasaman** (zambak, lila)      **jasaman** (jasaman) – zambak, lila  
- (*Turqisht - yasemin*; pers. – *jasāmān*; arab. - *jasāmūn*)
21. **jetim**      **jetim** (jetim) = jetim;  
**vorp** (vorp, vorb) = jetim  
- (*Turqisht* < arab. - *yetim*)
22. **kaçak** (trim, rebel)      **kaçak** (k<sup>h</sup>axh, k<sup>h</sup>aç) = trim  
- (*Turqisht - kaçak*)
23. **kandil** (fener)      **kandil** (kanteh, ganteh) = kandil,  
fener  
- (*Turqisht* < arab. - *kandil*)
24. **kanun** (ligj)      **kanun** (kanon, ganon) = ligj, kanun  
- (*Turqisht* < arab. - *kanun*)
25. **këna** (vaj bimor me ngjyrë të zezë)      **hina** (hina) = këna  
- (*Turqisht kina* < arab. - *hinnā*)
26. **kopsë** (komçë)      **kopsë** (koçak, goxhag) = kopsë;  
buton  
- (*Turqisht - kopsa*)
27. **llapa** (pilaf pa shumë yndyrë)      **llapa** (lap) – çorba e qenit  
- (*Turqisht - lapa*) (“lexo – *llapa*”)

28. **maraz** (inat, hidhërim, mërzi) **մարաշխունի** (marrak<sup>h</sup>ugh) = mjegull  
- (Turqisht – **maráz**)
29. **marule** (sallatë jeshile) **մարուլ** (marol) = sallatë jeshile  
- (Turqisht – **marùl**)
30. **mjaullij** **մլաւլեղ** (mlavel) = mjaullij  
- (Turqisht – **miyavlamak?**)
31. **nanë\*** (dial.) (nënë, mama) **նան** (nan) = nënë, mama  
- (Turqisht – **nine**)
32. **nishan** (shenjë) **նշան** (nshan) = shenjë, nishan  
- (Turqisht < pers. – **nishan**)
33. **oxhak** **օջախ** (oxhak<sup>h</sup>, oçak<sup>h</sup>) = oxhak  
- (Turqisht – **ocak**)
34. **pallavra\*** (fjalë të kota - F.GJ.SH) **բարեր** (barrer, parrer) – fjalë  
- (Turqisht – **palavrací**) (Spanjisht – **palabra**)
35. **pambuk** **բամբուլ** (bambak, pampag) = pambuk  
- (Turqisht – **pambuk, panbuk, pamúk**)
36. **pupël** **բմբուլ** (pëmpul, bëmbul) = pupël  
- (Turqisht – **pupla**)
37. **tajë** (kujdestare fëmijësh) **դայակ** (dajak, tajag) = dado (kujdestare fëmijësh)  
- (Turqisht – **tayá** < pers. – **dajé**)

38. **trastë** (thes, torbë)                      **унурул** (toprak, dobrag) = trastë,  
thes, torbë  
- (Turqisht – **torbá** (dikur – **tobrá**))
39. **zift** (serrë)                                **уз** (sev) = i, e zezë  
- (Turqisht – **zift** (< arab. – **zift**))

(Totali: Nga fjalori i mësipërm janë gjendur këto 39 fjalë të ngjashme, që gjenden njëkohësisht të paktën në 3 prej këtyre gjuhëve)

## VROJTIME DHE INTERPRETIME FJALËSH TË VEÇANTA

1. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Jerm”. (Fq. 28) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
2. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Mesopotamia”. (Fq. 35) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
3. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Pluhur” – (Polvere, Powder, etj). (Fq. 234 dhe 310) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
4. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Ora”. (Fq. 292) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
5. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Arno” – krijuesi. (Fq. 348 - 349) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
6. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “THI” – krijuesi. (Fq. 350) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
7. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Gur” dhe “Garnizon”. (Fq. 377) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
8. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Ania” – nave, etj. (Fq. 492) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
9. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “KAE = qaje”. (Fq. 449) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
10. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “UGUR”. (Fq. 499) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)

11. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Gajret”. (Fq. 502) Գաւի, (kan, gan) – thirrje, britmë (Ka lidhje me Gajret ??) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
12. Të shihet si e trajton N. Vlora fjalën “Yll” – (star, stella, stern, astra, etj). (Fq. 518) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
13. Të shihet si e trajton S. Konda zgjedhimin e fojes “Jam” (jem, jes, e). (Fq. 52) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
14. Të shihet si e trajton S. Konda fjalën “Shur (Rana)”. (Fq. 232 – 233) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
15. Të shihet si e trajton S. Konda fjalën “De (Dhe, Dheu). (Fq.369 - 370) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
16. Të shihet si e trajton V. Setian etimologjinë e fjalës “Malet Karpate”. (V. Setian, përkth. Shqip., Fq. 57)
17. Të shihet si e trajton Zaharie Majani fjalën - *cena* (A), “çmim, vlerë, shpërblim”. (Fq. 124) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
18. Të shihet si e trajton Zaharie Majani fjalën “Tun” = shtëpi. (Fq. 366) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
19. Të shihet si e trajton R. Ellis fjalën “bukë”. (Fq. 15) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
20. Të shihet si e trajton Aristidh P. Kola fjalën “Mani – Morea”. (Fq. 222) (Të bëhet krahasimi Shqip - Armenisht)
21. Kuriozitet B. P.: “Fjalë të ngjashme Spanjisht – Shqip”
22. Trajtimi i fjalëve që kanë lidhje me “muzgun, mugëtirën, errësimin, natën”.
23. Trajtimi i fjalëve të gjuhës Armene që kanë lidhje me “dritën, ndriçimin, lindjen e dritës”.
24. Veçori

## VROJTIME DHE INTERPRETIME (VR-IN)

### 1. (Vr-In) - 1

Emri *gjerman* është ilirisht: pranë Sofisë gjendet një banjë termike që në kohën e vjetër quhej *Germania*, dhe ky emër ilir kthjellet me anën e arm. *jerm* = ngrohtë. (Fq. 28)

*Shënim B.P.:* Shqip - JERM, ZJERRM (Zjarrmi)

Arm. - *ջերմ* (xherm, çerm) = zjarrmi, ngrohtësi

### 2. (Vr-In) - 2

Emri gjeografik MESOPOTAMIA – Kurdistan – Anadolli Lindor – Iraku i sotëm, del nga pellazgjishtja-ilirishtja-shqipja e vjetër.

- *Mes*, - i m.sh. e, et. Pika e vendi në qendër të diçkaje, pjesa e diçkaje që ndodhet në largësi të barabartë ose gati të njëjtë me të gjitha anët e skajet e saj; qendër, mesi i fushës, etj.

- *o*, *o* (oshtë, ashtë, është)

- *pot*, i m.sh. -a, -at. Brez, brez toke.

- *Am/ë*, - a f.sh. -a, -at. Vendi ku nis një rrjedhë uji, burim; shtrati i një rrjedhe uji. Ama e lumit.

- *ia* – prapashtesë pellazgjike-ilire-shqipe.

Kështu, MES – O – POT – AM - IA = Vendi i brezit (rripit) tokësor që ndodhet në mes të amës së lumenjve (Tigër dhe Eufrat) (Fq. 35 - 36)

*Shënim B.P.:* Shqip – MES – O – POT – AM - IA

Arm. – *ւեծ* (mec, mex) – i madh

*բոթ* (bot<sup>h</sup>, pot<sup>h</sup>) – lajm i keq, lajm i trishtueshëm

*փոթ* (p<sup>h</sup>ot<sup>h</sup>, pot<sup>h</sup>) – rrudhë, palosje; valëzim; gërshet

*փոթորիկ* (p<sup>h</sup>ot<sup>h</sup>orik, pot<sup>h</sup>orig) – furtunë, stuhi

*տամ* (tam, dam) – jap

Në gjuhën Armene kemi dy togfjalësh që mund të interpretohen në këtë mënyrë:

a. *ւեծ բոթ տամ* (mec bot tam, mex pot dam) = jap një lajm të keq të madh; MEC - BOT - TAM, MEX - POT - DAM

b. *ւեծ փոթ տամ* (mec pot tam, mex pot dam) = jap një rrudhosje të madhe, (stuhi të madhe ??); MEC - POT - TAM, MEX - POT - DAM

### 3. (Vr-In) - 3

**PLU** është pikërisht bazë e të gjitha fjalëve të të njëjtit kuptim në të gjitha gjuhët neo-latine. (Fq. 234)

Pa dyshim është interesante të vërtetohet vazhdimësia e fjalës pellazgo-ilire **PLU**, në gjuhët e ndryshme. (Fq. 309)

Në shqip bëhet “PLUHUR”, në italisht “POLVERE”, në latinisht “PULVIS”, në frengjisht “POUSSIER” ose “POUDRE”, në spanjisht “POLVO”, në anglisht “POWDER”. (Fq. 310)

*Shënim B.P.:* Shqip – Pluhur

Arm. - *փռշի* (poshi) = pluhur, hi

#### 4. (Vr-In) - 4

Në pjesën e lartë të vazos lexojmë:

“ARNO SË ORE”

Këtu “ORA” ka kuptimin e “KOHËS” filozofike dhe jo të sahatit.

Këtë mbishkrim ne mund ta interpretojmë vetëm në këtë mënyrë:

“KRIJUES I KOHËS”

Në këtë shprehje me përmbajtje brendore të thellë, takojmë filozofinë e Gjithësisë. (Fq. 292)

*Shënim B.P.:* Shqip – ORA

Arm. - *օր* (or) = dita (në kuptimin kohor, p.sh.:

ditë e bukur; ditë e enjte

pas sa ditësh e mbaron këtë punë?; etj.)

#### 5. (Vr-In) - 5

... Fjala “ARNO” në lashtësi kishte një kuptim më të lartë se ai që ka sot në gjuhën shqipe. ....

...

Besoj, pra, se me të drejtë e vendosa, mbasi lexova ato mbishkrime, se fjala “ARNO” kishte kuptimin e “KRIJUESIT”. (Fq. 348)

Dhe tani e dimë se fjala “ARNO” sot përdoret vetëm në Shqipëri, dhe se e ka humbur kuptimin e lartë të “KRIJUESIT” që kishte në lashtësi, për t’u ndryshuar në “ndreqës, arnues, arnues të diçkaje”. (Fq. 349)

*Shënim B.P.:* Shqip – ARNO

Arm. - *արնոյ* (arrnogh, arrnoh) = marrës

Arm. - *արնել* (arrnel) = me marrë

Arm. - *անոյ* (anogh, anoh) = bërës, krijues

Arm. - *անել* (anel) = me bë

## 6. (Vr-In) - 6

Një tjetër vërejtje i duhet kushtuar fjalës “THI”, e cila nuk ka të bëjë me derrin e egër, me thiun, por në këtë mbishkrim e ka kuptimin figurativ. Njeriu THI është njeri i fortë, i qëndrueshëm, i paepur.

... Neve sot do të thonim: është i fortë si luani (Fq. 350)

*Shënim B.P.:* Shqip – Derr (Thi)

Arm. - *տեր* (ter, der) = zotëri, zotërues, zot

## 7. (Vr-In) - 7

Edhe në Etruri gjinden emra qytetesh e kështjellash me fjalën **GUR**, si p.sh. GORTONA (gur tona ?), GYRTONION (gur të jonë), GORTINAIA (i gurti prej naje) dhe GOURASION, emri i një kështjelle në Etruri.

Nuk ka dyshim se nga fjala GOURASION, është formuar GARNIZONI i shqipes, GUARNIGIONE e italishtes dhe GARRISON i anglishtes. Është krejt e natyrshme, që kështjellat, garnizonet dhe banesat të ngriheshin me gurë, dhe të ishin të ngurta. (Fq. 377)

*Shënim B.P.:* Shqip – Gur

Arm. - *քար* (khar) = gur

Arm. - *կորիզ* (koriz, goriz) – gur, bërthamë,  
pjesa e fortë në brendësi të frutit

dhe mbrojtëse e farës së frutit

**8. (Vr-In) - 8**

Fjala ANIA, pa dyshim ka një prejardhje të përbashkët në gjuhët indoeuropiane, si p.sh:

Pellazgo-Ilirishte	“ANIA”
Etruskishte	“OANIA”
Shqipe	ANIA
Hebraishte	“ONIA”
Sanskritishte	“NAU”
Portugalisht	“NAU” ose “NAVIO”
Persishte	“NAV”
Italishte	“NAVE”
Rumanishte	“NAVA”
Spanjishte	“NAVIO”
Latinishte	“NAVIS”
Anglishte	“NAVY”

(Shënim: rrënjë e përbashkët)

*Shënim B.P.:* Shqip – Ania, Anija

Arm. - նավ (nav) = anije

**9. (Vr-In) - 9**

**KAE=qaje.** Në Durrës është zbuluar një epigraf, i cili ka afërsi mendore e shpirtërore me atë të Viterbo-s: KAE = qaje, në Shqipen e sotme. Në alfabetin pellazgo-iliro-etrusk, letra (germa) “q” nuk ekzistonte fare: ajo është formuar në kohëra shumë të mëvonshme. (Fq. 449)

*Shënim B.P.:* Të krahasohet me alfabetin Armen, të cilit i mungon letra (germa) “q”.

Një Armen fjalën shqipe “qaj” do ta shqiptonte “kaj”; “qaje” do ta shqiptonte “kaje”; fjalën “njëqind” do ta shqiptonte “njëkind”; fjalën “qen” do ta shqiptonte “ken”, etj.

## 10. (Vr-In) - 10

Një interes të veçantë na paraqet fjala në gjuhën turke “UGUR” (urim), meqë pajtohet po me këtë kuptim edhe në gjuhë të tjera të hapësirës Europiane, fjalë e cila përdoret që në kohëra shumë të lashta. Ta analizojmë këtë fjalë:

ETRUSKËT:	“AUGURE” (ata që parashikonin fatin e njeriut)
ILIRO-SHQIPTARËT:	“UGUR” (njeri ugurmire ose ugurzi)
<i>Shënim B.P.:</i>	Sot në shqip përdoret edhe “OGUR” (fat, shenjë e mirë; F. GJ.SH.)
LATINËT:	“AUGURE” (të njëjtin kuptim të Etruskishtes)
ITALIANËT:	“AUGURI” (Urime)
TURQIT:	“UGUR” (Ugurlu insan: njeri që sjell të mirën; Ugursuz insan: njeri që sjell të keqen)
ANGLEZËT:	“AUGUR” (Augur well - që sjell, që tregon të mirën; Augur ill - që sjell, që tregon të keqen;)
FRANCEZËT:	“AUGURE” (Me kuptimin e mësipërm)
SPANJOLLËT:	“AUGURAR” – DESEAR = Urime
PORTUGEZËT:	“AUGURE” – DESEO FELICIDAD = Urime
GREKËT E LASHTË:	“AUGE” (Dritë, rreze. AUGE në italisht: LAVDI)
GREKËT MODERNË:	“EFKI”(nuk ka të bëjë me gjuhët e tjera)
RUMUNËT:	“URARE” (Si AUGURARE në italisht dhe si URIMI ynë)

Si mund të vërtetohet lehtësisht, kjo fjalë duhet të ketë origjinë pellazgjike dhe është përdorur dhe përdoret ende sot në hapësirën Europiane, duke përfshirë edhe turqishten, që pa dyshim, e ka përvetësuar nga kulturat e mëparshme, kur i ka zaptuar ato troje.

(Fq. 499 - 500)

*Shënim B.P.:* Shqip – Ugur, Ogur

Arm. - *tł* (jek, jeg) = ardhje, mbërritje; i huaj

Arm. - *tłnłp* (jekur, jegur) = (mën. urdh.)

eja!, hyr! (ftesë për mirëseardhje)

*Të kihet parasysht:* Në gjuhën Armene, germa e bashkëngjitur “*t*” – *je*, kur është në fillim të fjalës lexohet si “*je*” në shqip, ndërsa kur është në mes të fjalës lexohet si zanorja “*e*” e shqipes.

Po të kemi në konsideratë vetëm dy trajtat dialektale të Armenishtes, atë Lindore dhe atë Perëndimore, si edhe mënyrën individuale të përdorimit në popull të germës së bashkëngjitur “*t*” – *je*, do kishim respektivisht:

Arm. Lind. - *tłnłp* (jekur) = eja!, hyr!     **JEKUR** ose **EKUR**

Arm. Perënd. - *tłnłp* (jegur) = eja!, hyr!     **JEGUR** ose **EGUR**

Fjala e përdorur për të mirëseardhur (ftuar) një njeri besoj se nënkupton edhe shfaqje të interesit për të ditur se çfarë sjell ai me vete (sende apo fjalë, lajme; të mira apo të këqia qofshin, ndonëse ftesa bëhet me shpresën për të pasur sende apo fjalë, lajme të mira).

Në këtë vështrim mendoj se nuk është pa interes të merret në konsideratë kjo fjalë, si e ngjashme me: “UGUR” (njeri ugurmire ose ugurzi), si fjalë e përdorur nga ILIRO-SHQIPTARËT (shih më sipër)

## 11. (Vr-In) - 11

Fjala “GAI” e këtij mbishkrimi, ka mundësi të kundërshtohet prej ndokujt, prandaj meriton një shpjegim të përsosur:

“GAI” në pellazgo-ilirisht, GARJ në sanskritisht do të thotë: Bërtitje e fortë, ulërimë, GAJRET në turqisht do të thotë: Ki durim (në raste dhimbjeje shpirtërore ose fizike: GAJRET ET: - “mbaje veten, duroje dhimbjen”).

Në fillim kjo fjalë ishte ndoshta vetëm “GAI” mandej, në sanskritishte është bërë “GARJ” dhe në turqisht “GAJRET”. Në të vërtetë, këtë fjalë turqishtja e përdor shpesh me prapashtesën “ET” = “KI”, që pikërisht do të thotë: KI DURIM (GAJRET ET). Nuk jam në gjendje, sot si sot, të them nëse sanskritishtja ka një prapashtesë të tillë, meqë turqishten e flas që në fillim të jetës, kurse nuk kam praktikë të foluri me sanskritishten. Prandaj, çdo ndihmë, përta i përket sanskritishtes, do të jetë e mirëpritur (Fq. 501 - 502)

*Shënim B.P.:* Shqip – GAJRET = kurajë, durim (F.GJ.SH.)

Arm. - *ղայրմւ* (kajun, gajun) = i qëndrueshëm,  
i fortë, i durueshëm

*կանք անկել* (kank, gank arnel) - të jetë i qëndrueshëm

*Կայր* (kajk, gajk) – ndalesë, qëndresë

*Të kihet parasysh:* Në të gjitha rastet kemi të bëjmë me rrënjën “GAJ”

## 12. (Vr-In) - 12

“YJ”: edhe kjo fjalë, sot, i përket vetëm gjuhës shqipe, megjithëse ishte e përhapur në të gjitha mbishkrimet e lashtësisë, nga Egjeu deri në Atlantik, si p. sh. në Gadishullin Iberik, si do ta kemi rastin ta vërtetojmë më poshtë.

**YJ – Yjnor – Hyjneron**, janë shprehje që kanë mbijetuar vetëm në gjuhën tonë, me prejardhje pellazgo-ilire, dhe i hasim në dokumentat epigrafike të Etrurisë, kurse në gjuhë të tjera të lashta kemi:

ASTRA	quhet	“qielli”	(në Sanskritishte)
ASTRO-ASTRI	quhen	“yjet”	(në Italishte)
ESTRELLA (ESTREJA)	=	“yjet”	(në Spanjishte)
ESTRELA (ESTRELA)	=	“yjet”	(në Portugalisht)
STAR- STARS	=	“yjet”	(në Anglishte)
ASTRO- ASTERI	=	“yjet”	(në Greqishte)
STEA e VEDETA	=	“yjet”	(në Rumanishte)
SETAREH	=	“yjet”	(në Persishte)
STERN	=	“yjet”	(në Gjermanishte)

Duke arsyetuar mbi fjalën “**YJ**”, e cila përdorej, përse kam zbuluar deri tani, nga pellazgët, ilirët, etruskët dhe sot mbijeton vetëm në gjuhën shqipe, mund të konsiderohet me të drejtë, se kjo fjalë i përket periudhës para-indoeuropiane. (Fq. 518)

*Shënim B.P.:* Shqip – Yll, Hyj, Hyu - Yjor, Hyjor, Hyjnor, etj

Arm. – *uuunη* (asth, asdh) = yll

Arm. – *hnlph* (huri, hyri) = bukuroshe, hyri, peri  
(në kuptimin - “yll e bukur”, “e bukur si yll”

– njëlloj si në Shqip)

Të shihet që në gjuhën Armene i kemi të dy format:

Formën me “ast” si në gjuhët e sipërpërmendura

Formën me “hju, hy” si në gjuhën Shqipe

### 13. (Vr-In) - 13

Krahasimi i foljes “jam” në Shqip dhe Armenisht. (S. Konda, Fq. 52)

Koha e tashme e mënyrës dëftore të foljes “me qenë”

<i>Japetike</i>	<i>Shqipe (S.K.)</i>	<i>Shqipe (B.P.)</i>	<i>Ermene (S.K.)</i>	<i>Armene (B.P.)</i>
As-mi	<i>Jam</i>	<i>Jam</i>	<i>Em</i>	<i>Jem (em)</i>
As-si	<i>Je</i>	<i>Je</i>	<i>Es</i>	<i>Jes (es)</i>
As-ti	<i>Asht</i>	<i>Asht (Është, A)</i>	<i>E</i>	<i>E</i>
As-mas	<i>Jena (Jemi)</i>	<i>Jemi(Jena)</i>	<i>Enk</i>	<i>Jenk (enk)</i>
As-tas	<i>Jeni (Ini)</i>	<i>Jeni (Jini)</i>	<i>Ek</i>	<i>Jek (ek)</i>
As-nti	<i>Jan</i>	<i>Janë</i>	<i>En</i>	<i>Jen (en)</i>

*Sqarim i shkurtimeve: S. K. – Spiro Konda; B.P. – Berzh Piranjani*

### 14. (Vr-In) - 14

Duke trajtuar fjalën “RANA” (Fq. 232 - 233), Spiro Konda shkruan:

“Në gjuhën shqipe kemi katër fjalë me këtë kuptim:

Shur

Kum

Ran dhe (rara)

Tin

Nga këto fjalë do analizojmë vetëm fjalën e parë “shur”, që është e barasvlershme me “zhur” (“gurë të vegjël bashkë me rërë, zhavorr” - sipas F.GJ. SH.).

Sipas F.GJ. SH. për fjalën “zhavorr” kemi këtë shpjegim: - rërë përzier me gurë të vegjël; zhur, zall.

Siç shihet fjala “**shur**” (zhur) e gjuhës Shqipe – mund të njësohet me fjalën “rërë” ose “shkëmb i thërmuar”.

Në Armenisht kemi - “đujn” (zhajr) – shkëmb. Gjithashtu, për fjalën shqipe “thërrime” në Armenisht kemi - “փշուր” (pshur) = thërrime, dhe փշուր (pëshrank) = thërrime. Po të kemi parasysh, që “zhuri” apo “rëra” nuk është gjë tjetër veçse një grumbull “thërmijash” nga gryerjet shkëmbore, mendoj që ja vlen të trajtojmë problemin e ngjashmërisë së fjalës Shqipe “shur” (zhur), apo “zhavorr” me fjalët Armene sipërpërmendura. Po i paraqes në tabelën e mëposhtme:

*Shënim B.P.:* Shqip – SHUR (ZHUR)

Shqip – ZHAVORR

Arm. – *đujn* (zhajrr) – shkëmb

Arm. – *փշուր* (pshur) = thërrime

Arm. – *փշուր* (pëshrank) = thërrime

## 15. (Vr-In) - 15

Duke trajtuar fjalën “De (Dhe, Dheu), Spiro Konda shkruan:

““De” është fjalë pellazgjike, që do të thotë “tokë” dhe që është fjala e sotme shqipe “dhe””. (Fq.369 - 370)

*Shënim B.P.:* Shqip – DHE (Dheu)

Arm. – *տեղ* (degh, deh) = vend; tokë; dhe, përdhe

## 16. (Vr-In) - 16

Malet Karpate janë një varg malesh me gjatësi rreth 1500 km., që i ngjan një “pengesë murale” të stërmadhe. Etimologjia e saj mund të shpjegohet me gjuhën Armene “kar-pat”, që fjalë për fjalë do të thotë “mur guri” ose “mur shkëmbor”, përkthim ky që përputhet me relievin e paraqitur në hartë. (V.Setian, përkth. Shqip., Fq. 57)

*Shënim B.P.:* Shqip – Karpāt

Arm. – *քարպատ* (karpāt) = mur guri

Për Sqarim:

Në Armenisht shkruhet – *քար*; lexohet - kar; në Shqip përkthehet - gur;

Në Armenisht shkruhet – *պատ*; lexohet – pat; në Shqip përkthehet - mur

Përfundimisht:

Në Armenisht shkruhet – *քարպատ*; lexohet – karpāt; në Shqip përkthehet – mur guri)

### 17. (Vr-In) - 17

*cena* (A), “çmim, vlerë, shpërblim”. Një rrënjë e vjetër Indoeuropiane me të cilën lidhet *kaena* (tek Avesta), *kaina* në gjuhën skithe, *poine* e greqishtes, *tzena* slave, *cenis*, “vlerësoj” e shqipes. (Fq. 124)

*Shënim B.P.:* Shqip – çmim

Arm. – *գին* (gin, kin) = çmim

### 18. (Vr-In) - 18

*Θun* është me të gjitha gjasat “shtëpia” sikurse do ta shohim më tej; krahaso: dhomë, në shqip (Fq. 178)

Fjala *θun*, “shtëpi”, e analizuar prej nesh na jep mundësinë t’u kthejmë Etruskëve një relike të së kaluarës së tyre, e cila u ishte marrë atyre për t’ia dhënë atë Keltëve. (Fq. 366)

*n* -ja Etruske është ngandonjëherë – *m* e Shqipes: *θun* i korrespondon fjalës *dhomë* të Shqipes, “shtëpi” (Fq. 537)

*Shënim B.P.:* Shqip – Shtëpi

Arm. – *unnlú* (tun, dun) = shtëpi

(*θ =th*)

## 19. (Vr-In) - 19

Dr. Parrot, në shkrimin e tij “Udhëtim në Ararat” përmend një lloj buke Armene të quajtur “bokon” (angl. - bockon). (Fq. 15)

*Shënim B.P.:* Shqip – bukë

Arm. – *huq* (hac) = bukë (haje ??)

## 20. (Vr-In) - 20

ETIMOLOGJIA E MANIT – MORESË (Fq. 222)

Edhe vetë emërtimi Mani, siç pohuan të parët Kanelidhi dhe Fukiri, ka prejardhje shqiptare. Vjen nga fjala e gjuhës shqipe “man” (apo mën), pra pema e manit. Do të përmend dhe variante të tjera që janë mbështetur deri më sot:

- 1 Sipas njërit version emërtimi i Manit erdhi nga fjala latine Manus që do të thotë dorë.
- 2 Sipas një tjetri erdhi nga italishtja Ammanaire, që do të thotë “merrem me velat, rrjetat e anijes”.

Varianti i prejardhjes shqiptare ka si mbështetje:

1. Faktin se me të vërtetë Mani dhe Moreja, ishin në vitet pas Bizantit, vendprodhimi i mëndafshit dhe kultivohej pema e manit.
2. Prania e arbëreshëve në Man gjatë emërtimit të tij, ashtu siç pamë.
3. Ekzistenca e një emri të tillë dhe në vende të tjera, të cilat nuk kanë asnjë lloj lidhje me dorën apo rrjetat e versione të tjera etimologjike (emri Mani ekzistonte dhe në vende të tjera të Greqisë thotë Kanelidhis, p.sh. në Grevenë).

4. Emërtimi i mëpasëm i Peleponezitet në More (vjen nga fjala greke “muria”, që do të thotë Man), tregon se emri i ri i Peleponezitet nuk është veçse përkthimi nga shqipja në greqisht i fjalës Man, Mën.

Kështu zgjidhet dhe problemi i emërtimit të mëpasëm të Peleponezitet, në More, d.m.th. nga Mani dhe Mistra mori emrin e tij e gjithë pjesa tjetër e gadishullit.

*Shënim B.P.:* Në gjuhën Armene kemi:

1. *մանանա* (manana) - man
2. *թուր* (tut) - man
3. *մոշ* (mosh) - manaferrë
4. *մորենի* (moreni) – manaferrë, mjedër

Mos vallë: *մանանա* (manana) – man dhe *մորենի* (moreni) – manaferrë, mjedër, të gjuhës Armene, kanë po atë të drejtë si edhe fjalët “man, mën” të gjuhës Shqipe, të merren në shqyrtim kur analizohet emërtimi “More” i Peloponezitet?

## 21. Kuriozitet B.P.:

Fjalë të ngjashme Shqip – Armenisht - Spanjisht

<i>Shqip</i>	<i>Armenisht</i>	<i>Spanjisht</i>
<b>çika</b> (vajzë e re, gocë)	<i>աղիկ</i> (ahçik, ahçig)	chica
<b>arkë</b> (arkë e madhe)	<i>արկ</i> (ark <sup>h</sup> , arg <sup>h</sup> )	arcon
<b>sandalja</b>	<i>սանալ</i> (sandal, santal)	la sandalia
<b>ora</b>	<i>օր</i> (or)	hora
<b>pallavra</b> (fjalë boshe, kot)	<i>բարր</i> (barrer, parrer)	palabra

## 22. Trajtimi i fjalëve që kanë lidhje me “muzgun, mugëtirën, errësimin, natën”

	në gjuhën Armene
<b>Erret</b> (errësohet)	<i>ւթնւել</i> (mëtn'e'l) = erret, errësohet
<b>Errësirë</b>	<i>ւթնւթյուն</i> (mëtuju'n) = errësirë
<b>Errësoj</b> (err, ngryso)	<i>ւթնեզնել</i> (mëtnecne'l) = errësoj, err
<b>Errët</b> (errët, ngrysur)	<i>երեկո</i> (jereko', jerego', ereko, erego) = mbrëmje, darkë, në të errur, në të ngrysur
<b>Errët</b> (errësirë)	<i>ւթին</i> (mëtin) = errët, errësirë
<b>Errët</b> (i ngrysur)	<i>մռայլ</i> (mrrajl) = i errët, i ngrysur
<b>Errët</b> (i,e)	<i>մուգ</i> (mug, muk) = i errët, zeshkan
<b>Mugët</b> (Mugësirë)	<i>մռայլ</i> (mrrajl) = i errët, i ngrysur
<b>Murrët</b> (i vrenjtur, i ngryset)	<i>մռայլ</i> (mrrajl) = i errët, i ngrysur
<b>Mvrojtur</b> (i vrenjtur)	<i>մեռնաշահ</i> (mëtnasha'h) = muzg, mugëtirë
<b>Mvrenjtur</b> (i vrenjtur)	<i>մռայլ</i> (mrrajl) = i errët, i ngrysur
<b>Natë</b> (errësirë)	<i>գիշեր</i> (gisher, kisher) = natë, darkë, mbrëmje
<b>Terr</b> (errësirë)	<i>մութ</i> (mut) = terr, errësirë

Kombinimet mëposhtëme paraqiten më domethënëse:

në gjuhën Armene

<b>Mugët, Mugësirë, Murrët, Mvrojtur</b>	<i>մութ</i> (mut) = terr, errësirë
<b>Mugët, Mugësirë, Murrët, Mvrenjtur</b>	<i>մռայլ</i> (mrrajl) = i errët, i ngrysur, i mvrenjtur
<b>Err, Errësirë, Terr</b>	<i>երեկո</i> (jereko', jerego', ereko, erego) = mbrëmje, darkë, në të errur, në të ngrysur
<b>Err, Errësirë, Terr</b>	<i>գիշեր</i> (gisher, kisher) = natë, darkë, mbrëmje

### 23. Trajtimi i fjalëve të gjuhës Armene që kanë lidhje me “dritën, ndriçimin, lindjen e dritës”.

	në gjuhën Armene
Diell	<i>արև</i> (arev)
Diell	<i>արեգակ</i> (aregak, arekag)
Lindja e Diellit	<i>արևելք</i> (arevelk)
Zjarr	<i>կրակ</i> (krak, grag)
Agon	<i>ակ</i> (ak, ag) = burim, fillim; gur i çmuar
Agon (agimi)	<i>ակն</i> (akn, agn) – sy; gur i çmuar
Burim (fillim)	<i>ակ</i> (ak, ag) = burim, fillim; gur i çmuar
Yjësi (yllësi, hyllësi, hyjësi)	<i>լույս</i> (lujs) = dritë
Yjësi (yllësi, hyllësi, hyjësi)	<i>լուսին</i> (lusin) = hënë

*Shënim B.P.:* Yll = symbol i shkëlqimit (F.GJ.SH.)

### 24. Veçori

\*շ (ç) – në Armenisht përdoret për të kthyer një fjalë në të kundërtën e vet; njëlloj siç përdoret – ç, s, zh – në shqip; p.sh vendos – çvendos, është – s’është, etj. (në armenisht: է (e) – është; չէ (çe) – s’është).

\*շէ (çe) dhe նշ (voç) – përdoren edhe me kuptimin mohues – “jo” të shqipes

VEPRAT NGA JANË NXJERRË - (VROJTIM – INTERPRETIMET)  
- E MËSIPËRME DHE AUTORËT E TYRE:

*Nermin Vlorë Falaski*: “Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët”.  
(Shtëpia Botuese “Faik Konica”, Prishtinë, 1998; botuar për herë  
të parë: 1984, Itali)

*Spiro Konda*: “Shqiptarët dhe problemi pellazgjik”. (Botimi i parë:  
Tiranë 1964)

*Vahan Setian*: “Origjinat Armene të Baskëve”. (Përkthim shqip nga  
Berzh Piranjani, Tiranë, 2020)

*Zacharie Mayani*: “Etruskët fillojnë të flasin”. (Sh.B. “Fan Noli”,  
Tiranë, 2018; botuar për herë të parë 1973, Francë)

*Robert Ellis*: “Armenian origin of Etruscans”. Londër, 1861

*Aristidh P. Kola*: “Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve”, (Shtëpia  
Botuese “55”. Tiranë, 2002)

NË VEND TË MBYLLJES

**PEMA E GJUHËVE  
INDO-EUROPIANE**

[Nxjerrë nga shkrime të ndryshme]



ACCADEMIA CULTURALE

# ILIRIA



ΣΚΟΔΡΙΝΩΝ

Ilirico:  
SKODRINON

Albanese:  
Shko Drini

Italiano:  
Scorre il Dr

Inglese:  
The Drin flo

## DALL'ETNOCENTRISMO AL PLURALISMO CULTURALE

NGA ETNOCENTRIZMI NË  
PLURALIZËM KULTUROR--

FROM ETHNOCENTRISM T  
CULTURAL PLURALISM

BARDI EDITORE

PROTOLINGUA e PELASGO-ILLIRO-ETRUSCO

Pag. 169


PROTOGJUHA dhe PELLAZGO-ILIRO-  
ETRUSKISHTJA

Fq. 177

PROTOLANGUAGE and PELASGO-ILLYRO-  
ETRUSCAN

Page 185

"Popoli, Geni e Lingue", grafika e prejardhjes së gjuhëve, ndërtuar prej dy nxanësve të Cavalli Sforçé-së: **Alberto Piazza dhe Eric Minch:**



Në botën tonë ka një horizont që nuk lejon shtyrjen e shikimit tonë përtej tij. Dhe, nuk ka dyshim se, persa i përket lashtësisë, horizonti ynë ndalet te **Pellazgët Yjnor**, "shpikës të alfabetit fonetik" popuj të Detit, të cilët i quajtën "Iliri" trojet e banuara nga njerzit e tyre të lirë.

E vërteta historike dhe veçanërisht ajo e gjuhësisë, dalin në dritë duke e ngjitur unazat e ndryshme të ngjarjeve, për formimin e një zinxhiri të gjatë, në përmasën e tij me të gjërë, me kujdes të madh e me përkushtim të veçantë, në mënyrë që kultura mos të bëhet peng i propogandës. Dhe, duke i mbetur besnik këtij parimi, ia vura themelet gjurmimeve të mia mbi Pellazgët, thjeshtësisht, duke i vendosur së bashku, njëri pas tjetrit, unazat e çmuara të të dhenave shkencore të shkruaritave të mirënjohur të lashtësisë, nga Homeri, Herodoti, Tuqiditi, Virgjili, Pausania, etj. deri tek ata studiues të lirë të ditëve tona.

Nëse duam t'a përballojmë me baza shkencore të vërteta dhe me pa anësi këtë studim, duhet të kemi kujdes që mos të bëhemi viktimë të **Horror Novi**-it. T'i analizojmë me urtësi dhe pa paragjykimë jehonat e lajmeve të çmuara, të ardhura nga lashtësia e hershme, kur emëri i vendeve nuk konsiderohej i huaj nga fiset sapo të ardhur, ashtu si edhe nuk njiheti nevoja e këmbimit të emrave, me paragjykim të posatshëm, për t'ia dhënë historisë përmasën e interesit politik ose vetiak të kohës.

Dihet fare mirë se, para ardhjes së Heleneve në trojet që sot njihen si "Greqi", ata vende quheshin "Pellazgji". Ja se si vërtetohet ky fakt nga autorët e lashtësisë.

**Homeri (Iliada-v.681-685):**

*"Aso kohë, ata që banonin në Argolidën Pellazgjike (...)quheshin Mirmidon, Helen dhe Akej".*

Homeri e quan "Pellazgjike" Argolidën dhe jo Akej.

**Herodoti (Historia, Libri VIII, kap.44):**

*"Në kohë kur Pellazgët banonin në trojet që sot quhen Hellad, athinasit ishin pellazgë, të fisit të Kranoit (...)por kur u helenizuan, e ndruan edhe emrin e tyre".*

**Tuqididi (libri I, kap.3)**

*"Përpara Helenit Deukalion, ky emër "Hellas" nuk gjindei fare: popullsira të tjera e veçanërisht populli Pellazgjuk ia dhanë vendit emërin e tyre".*

Pausania (Arkadia, libri VIII, 1,4,6)

*"Arkadët thojnë se Pellazgu ishte njeriu i parë që lindi në tokën e Arkadisë. Dhe, meqë Pellazgu u bë mbret, Vendi u quajt "Pellazgjë".*

Virgjili (Eneide, VIII, v.602-603)

*"Thuhet se banorët e parë të Italisë sonë ishin Pellazgët".*

Mos të harrojmë se ende gjenden në Itali vende që e rruanjné emrin e Pellazgve si p.sh. **Isole Pelasgie**, afër Siquilisë dhe në veri, afër Padovas. **Le Terme Pelasgie**. Pak km. përtej Firences, hasemi me vendin që mban emërin **Pelago** dhe afër Modena-s, gjindet qyteti **Pieve-Pelago**.

Pa dyshim, interesë të veçante gjuhësorë dhe historikë deshmohet nga emri që mbajnë: **Mali Liri**, **Qyteti Liri** dhe **Lumi Liri**, të cilët gjenden në Lacio të Italisë, nja 40 km. në jugë të Romës.

Për ta bërë sa më të qartë analizën tonë në këtë shkrim, duhet të kemi të pranishëm, gjithmonë, se **Pellazgët Yjnor** ishin ata që e shpikën alfabetin fonetik. Si dihet, më parë shpreheshin me "**hieroglifike ose me ideograma**". Prandaj, me bindje të plotë mund të themi se qytetërimi i vërtetë fillon me **Pellazgët Yjnor dhe të Lirë, të cilët e quajtën "ILIRI"** vendbanimin e tyre. Iliria shtrihej nga Egjeu deri në Danub.

Nuk ka dyshim se shkrimi është mjeti i vetëm për përhapjen e kulturës në skajet e ndryshme të botës, ashtu si, në fakt, ka ndodhur Pellazgët, duke qenë lundruar të lire dhe të afte, e përcollën gjuhën, alfabetin e kulturën e tyre kudo që vajten. Dhe, studimi i gjuhësise, na dëshmon se ata kan vajtur shumë më largë se sa e ka pranuar shkencën e ditëve tona!

Tashti, për vërtetimin e një shkence të përpiktë, duhet të rruhem, me çdo kusht, nga ai mentalitet i përhapur në ditë tona, me perkrahjen e kësaj shprehjeje të latinishtes "**Damnata quod non intelligit**". (e denojë, meqë nuk e kuptojë)! Pra, të perpiqemi dhe mos të denojmë me perbuzeje çka është zbuluar, me mundime të mëdhaja, vetëm pse nuk perputhet me tezat tona, ose në kundërshtim me interesat tona. Përsa i perket Italisë, kemi dëshmi nga shkencetarë të ndryshëm, të cilët e perkrahin tezën e prejardhjes **Pellazgo-Ilire** të italianëve. Ta vërtetojmë këtë tezë në formë shkencore:

**Diodor Siquilioni** na informon se dhjetë shekuj para K. përdorei alfabeti i Pellazgve dhe nënvizon se, të parët që e sollën alfabetin e tyre në Itali dhe në Evropë, duke bërë disa përshtatje, ishin vetë Pellazgët.

**Plini Plakë** e vërteton lajmin se Pellazgët ishin ata që e sollën në Itali' alfabetin fonetik.

**Seneca**, me anë të hartës gjeografike të tijë, dëshmon periudhën e arrdhjes së Etruskëve në Itali. Ai shprehet pikerisht në këtë mënyrë:

*"Etruskët numëronin me "saecula" historinë e tyre dhe mendonin se "saeculum" i parë fillonte në shekullin 1200-1100 para K.*

Në këtë përmbledhje të shkurter të studimit tonë, besoj se nuk është i rastit të zgjatemi më tej me autore të lashtësise. Të mësojmë pak edhe mendimin e disa studiuesve të dy shekujve të fundit, për të patur një pamje dëshmuese më të përpiktë, të historisë dhe gjuhësise sonë me interesë të jashtzakonshme:

**Francesco Ribezzo "Iscriptionum Messapicarum"** (1944), pranor concordancën të shumëta midis onomastikës Venete, Japixhe, Ilire dhe shqiptare.

**Alfredo Trombetti**, confermon se fise Ilire u përhapën në gjith Gadishullin Italik, nga Venediku, në Pulia e në Kalabri.


**Elia Lattes**, pohon se nuk ka arsye që mos të pranohet origjina Ilire e popujve Italik.

Nxjerrë nga Libri: "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Pellazgët"; Nermin Vlora

1) Vizatimi paraqitet me gjuhën "ALBANESE", si fillimi i të folmeve, nga ku kanë shpërthyer gjuhët e tjera. Unë do ta quaja Pellazgo-Ilirishte, meqë fjala "Albanese" nuk ekzistonte, por duket se në studimet e tyre ata u bazuan mbi emrat që përdoren sot: emra aktualë për shprehje teknologjike moderne:

2) Edhe fjala "ÇELTË" (gjyrë e çeltë) e ka kuptimin vetëm në gjuhën shqipe, ashtu si edhe "BALTA" (Baltike). Sa për emrat e tjerë, t'i mënjanojmë tash për tash, meqë nuk kam dokumentime të mjaftueshme për transformimin e tyre.


Në faqen 244 të veprës: "GENI, POPOLI E LINGUE" të autorit L.L. Cavalli-Sforza, mund të vështrohet ky vizatim interesat nga pikëpamja e prejardhjes së gjuhëve:



*Shqip Armen Grek Çeltik Baltik Sllav Gjerman Itali Indian Iranik*

Cavalli-Sforza shkruan se me 1863, linguisti gjerman AUGUST SCHLEICHER botoi një dru të gjuhëve indo-evropiane që u afrohet shumë atyre të sotmeve. Por në atë kohë, shkruan ai, mungonin metodat







# PEMA FAMILJARE E GJUHËVE I KA RRËNJËT NË ANATOLI (ANADOLL) - KËSHTU THONË BIOLOGËT

Artikull i marrë në Internet; botim i “The New York Times” nën titullin:  
Family Tree of Languages Has Roots in Anatolia, Biologists Say

August 23, 2012

By NICHOLAS WADE

Biologët, duke përdorur mjete të zhvilluara posaçërisht për të studjuar evolucionin e pemëve familjare të gjuhëve, thonë se ata kanë zgjidhur një problem, që shtrohet prej shumë kohësh përpara arkeologjisë: origjina e familjes së gjuhëve indo-europiane.

Kjo familje përfshin gjuhën Angleze si edhe shumicën e gjuhëve të tjera europiane, si gjuha Persiane, Indiane e të tjera. Pavarësisht nga rëndësia e gjuhëve, për kohë të gjatë specialistët nuk kanë rënë dakord për origjinën e tyre.

Gjuhëtarët besojnë se folësit e parë të gjuhës amtare, të njohur si proto-Indo-Europiane, ishin barinj të shetitës, që dinin të ngisnin edhe të ashtuquajturat “*Qerre Luftarake - Charriots*” (një lloj karroce e vogël me dy rrota dhe që tërhiqej nga dy kuaj, e cila përdorej për gara ose për qëllime luftarake). Afërsisht 4 000 vjet më parë, ata u

derdhën nga stepat, që ishin vendqendrimi i tyre fillestar (atdheu i tyre), mbi tokat përreth Detit të Zi dhe pushtuan Europën dhe Azinë. Një tjetër teori, që rivalizon me të, thotë se, përkundrazi, folësit e parë Indoeuropianë ishin fermerët paqësorë të Anatólisë (sot – Anadolli), tani Turqi, rreth 9,000 vjet më parë, të cilët e përhapën gjuhën e tyre me shatë (vegël pune, që përdoret në bujqësi për të prashitur tokën), dhe jo me shpatë.

Debutuesi i ri në këtë debat është një biolog evolucionist, Quentin Atkinson, i Universitetit të Oklandit (Auckland) në Zelandën e Re. Ai dhe kolegët e tij kanë marrë fjalorin ekzistues dhe shpërndarjen gjeografike të 103 gjuhëve të ndryshme Indo-Europiane dhe me rrugë kompjuterike i kanë vendosur ato mbrapsht në kohë dhe vend sipas origjinës më të mundshme që rezulton nga statistikat e deritanishme.

Rezultati, të cilin ata e shpallën në “Thursday’s issue of the journal Science”, është se “kemi gjetur mbështetje të fuqishme vendimtare për një origjinë Anatólike (nga Anadolli) në krahasim me atë të ardhur nga stepat”. Si koha ashtu edhe rrënja e pemës së gjuhëve Indo-Europiane “përputhet me një ekspansion agrikorik nga Anatólia duke filluar nga 8,000 deri në 9,500 vjet më parë”-raportojnë ata.

Por pavarësisht metodave të tyre të avancuara statistikore, studimi i tyre nuk mund t’i bindë të gjithë.

Studiuesit filluan me një grup të zgjedhur fjalësh, të cilat njihen të jenë rezistente ndaj ndryshimeve gjuhësore, siç janë përemrat, pjesët e trupit dhe lidhjet familjare, dhe i krahasuan ato me fjalët përkatëse të gjuhëve paraardhëse proto-Indo-Europiane stërgjyshore. Fjalët, që kanë një linjë të qartë të prejardhjes nga e njëjta fjalë stërgjyshore, njihen si “*të afërm*” (prej një burimi). Kështu fjala “mama, nënë” (Shqip), “mother” (Anglisht), “mutter” (Gjermanisht), “mat” (Rusisht), “madar” (Persisht), “matka” (Polonisht) dhe “mater” (Latinisht) janë të gjitha “*të afërm*”, që rrjedhin nga fjala proto-Indo-Europiane - “mehter”.

Pas kësaj, Dr. Atkinson dhe kolegët e tij, i vendosën nga një shenjë çdo grupi fjalësh në fjalorin që e kishin përcaktuar si “fjalor bazë për studim” për 103 gjuhët e përmendura më sipër. Në gjuhët ku fjala ishte “*i Afërm*”, studiuesit vendosën shenjën 1; në ato kur “*i afërmi*” ishte zëvendësuar me një fjalë që nuk kishte lidhje me të, u vendos shënja 0. Kështu, çdo gjuhë mund të përfaqësohej nga një varg 1(njëshash) dhe 0(zerosh), dhe studiuesit mund të llogarisin (hartojnë) kompjuterikisht pemën familjare më të mundshme për të qenë reale, e cila tregon marrëdhëniet midis këtyre 103 gjuhëve.

Më pas, kompjuteri u furnizua me të dhënat e njohura rreth datave kur fillojnë të shfaqen ndarjet gjuhësore. Për shembull, gjuha Rumune dhe ato të tjera me bazë Romane filluan të devijonin nga Latinishtja pas viteve 270 të erës sonë, kur trupat Romake u tërhoqën nga provincat Romake të Dakëve. Duke aplikuar këto të dhëna në disa prej degëve të kësaj peme, kompjuteri ishte në gjendje të vlerësonte të dhënat edhe për gjithë të tjerët.

Gjithashtu, kompjuterit ju dha informacion gjeografik rreth vendpozicionimit aktual të secilës gjuhë dhe ju kërkua që të hartonte rrugët më të mundshme për të qenë reale të shpërndarjes duke filluar nga një origjinë dhe duke pasur parasysh pemën familjare të mundshme të prejardhjes. Përlllogaritja fiksoi Anadollin si pikë origjine, sidomos një zonë në formën e një thoi të zgjatur në atë vend, që tani është Turqia jugore, si origjina më e besueshme – rajon ky, që ishte propozuar si origjina e familjes Indo-Europiane edhe nga arkeologu Kolin Renfrew, në vitin 1987, i cili besonte se këtu ishte burimi, nga i cili agrikultura u përhap në Europë.

Puna e Dr. Atkinson ka përmbledhur dhe ndërthurur një sasi të madhe informacioni nëpërmjet një metode kompjuterike, e cila ka rezultuar e suksesshme në studimet me natyrë evolucionare. Por rezultatet e tij nuk mund të lëkundin nga pozicioni i tyre mbështetësit e teorisë rivale, të cilët besojnë se gjuhët Indo-Europiane janë përhapur rreth 5.000 vjet më vonë nga barinjte (fiset

endacake që merreshin me blegtori) luftarakë, që pushtuan Europën dhe Indinë duke ardhur nga stepat e Detit të Zi.

Një element kyç në arritjen e këtij konkluzioni është fakti, se gjuha proto-Indo-Europiane kishte një fjalor për “*Qerre Luftarake*” (charriots – në Anglisht) dhe “*Qerre-karrocë*” (wagons – në Anglisht), që përfshinte fjalë, që përdorreshin për “*rrota*” (wheel – në Anglisht), “*bosht - aks*” (axle – në Anglisht), “*shufër* – për dy shufrat e karrocës brenda të cilave mbrehet kali (harness-pole – në Anglisht) dhe “për të shkuar ose për të ngarë një mjet” (to go or convey in a vehicle – në Anglisht) . Këto fjalë kanë pasardhës të shumtë në gjuhët bija Indo-Europiane. Kjo i bën gjuhëtarët historikë të argumentojnë, që vetë gjuha Indo-Europiane nuk mund të jetë fragmentuar në ato gjuhë bija përpara shpikjes së “*Qerres Luftarake*” dhe “*Qerres-karrocë*”, shembujt e njohur më të hershëm të së cilës datojnë në vitet 3500 para erës sonë. Kjo do të përjashtonte çdo lidhje midis asaj që quhet Indo-Europiane dhe përhapjes së bujqësisë nga Anatolia (Anadoli), e cila ka ndodhur shumë më herët.

“Unë e shoh faktin e “mjeteve me rrota” si një një element të fortë bindës mbi çdo teori evolucionare të pemës së gjuhëve”, thotë David Anthony, një arkeolog në Kolegjin Hartwick, që studion origjinën Indo-Europiane

Gjuhëtarët historikë shohin prova të tjera në atë që folësit e parë Indo-Europianë kishin fjalë për “kalin” dhe “bletën” dhe ju kishin huazuar (dhënë hua) shumë fjalë bazë gjuhës proto-Uralike, gjuhës amtare të finlandezëve dhe hungarezëve. Vendi më i mirë për të gjetur kuaj të egër dhe bletë dhe për të qenë pranë folësve të gjuhës proto- Uralike është zona e stepës mbi Detin e Zi dhe Detin Kaspik. Njerëzit e Kurganit, që pushtuan këtë zonë rreth viteve nga 5000 deri në 3000 para erës sonë, kanë qenë cilësuar prej kohësh si kandidatë për të marrë emrin e “folësve të parë të gjuhës Indo-Europiane.

Në një libër të kohëve të fundit, “Kali, Rrota dhe Gjuha”, Dr. Anthony përshkruan se si njerëzit e stepës zhvilluan një shoqëri të

lëvizshme dhe një sistem shoqëror, që u mundësoi atyre të largoheshin nga vendlindja duke u përhapur në disa drejtime, duke përhapur njëkohësisht edhe gjuhën e tyre në lindje, perëndim dhe në jug.

Dr. Anthony thotë se ai e kishte gjetur pemën e gjuhëve Indo-Europiane të hartuar nga Dr. Atkinson të papranueshme (të pambështetur) në disa detaje. Për shembull, gjuha “Tokariane”, është një grup gjuhësh Indo-Europiane, që flitet në Kinën veriperëndimore. Dr. Anthony thotë se është e vështirë të përfytyrohet se si gjuha “Tokariane” mund të ketë emigruar atje nga Turqia jugore, ndërkohë që ka një migrim të njohur nga rajoni i Kurganit në malet Altai, që ndodhen në lindje të Azisë Qendrore; pjestarët e këtij migrimi mendohet të jenë paraardhësit e folësve të gjuhës “Tokariane”, të cilët jetuan në zonën përgjatë Rrugës së Mëndafshit (Silk Road).


Dr. Atkinson tha se ky ishte një “argument në ajër” dhe se këto supozime duhet të gjykohen në mënyrë sasiore.


Dr. Anthony, duke vënë në dukje se as ai dhe as Dr. Atkinson nuk janë gjuhëtarë, thotë se “*të afërmit*” janë vetëm një element përbërës për rindërtimin e pemëve gjuhësore dhe se duhet të merren në konsideratë gjithashtu edhe ndryshimet gramatikore dhe zanore (tingujt). Dr. Anthony thotë se rindërtimi i Dr. Atkinsonit është “një karrike me një këmbë, kështu që, nuk është për t’u habitur, që pema, që ai ka krijuar, përmban grupime gjuhësore, të cilat nuk do të mund të mbijetonin, nëqoftëse ju do të përfshinit në këtë studim edhe ndryshimet morfologjike dhe zanore (tingujt)”.

Në kundërpërgjigjen e tij, Dr. Atkinson thotë se ai në të vërtetë e ndërtoi simulimin e tij kompjuterik në një pemë të bazuar në gramatikë, hartuar nga Don Ringe, një ekspert për çështjet Indo-Europiane në Universitetin e Pensilvanisë; rezultonte që origjina të ishte përsëri Anatolia (Anadulli), dhe jo stepat Pontike.

## Tracing the Origins of Indo-European Languages

A new study suggests that the sprawling Indo-European family of languages originated in Anatolia, or modern-day Turkey. [Related Article »](#)





## B

### LITERATURA E PËRDORUR

(Renditja sipas Mbiemrit të Autorit)

Butskhrikidze, Marika: “Studjuesja Gjeorgjiane: Ngjashmëri intriguese ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes.” (Botuar në gazetën “Standart”, fq. 18, të datës “E Hënë, 09.12.2013”)

Dizdari, Tahir N. : Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe, Mileniumi i Ri, Tiranë, 2005.

Ellis, Robert: «Armenian origin of Etruscans». 1861 (botuar për herë të parë: 1861)

Instituti i Shkencave: Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1954

Piranjani, Berzh: Fjalor Armenisht – Shqip, (rreth 13 000 fjalë), albPaper, Tiranë, 2015

Piranjani, Berzh: Fjalor Shqip - Armenisht, (rreth 11 000 fjalë), albPaper, Tiranë, 2016

Piranjani, Berzh: Gramatika e Gjuhës Armene (Perëndimore dhe Lindore), albPaper, Tiranë, 2017

Piranjani, Berzh: INDO-EUROPA ; Shqiptarët dhe Armenët; Shqipja dhe Armenishtja, albPaper, Tiranë, 2021

*Shënim Informativ B.P.:*

Krahas materialeve sipërpërmendur janë konsultuar edhe një sërë fjalorësh të tjerë të gjuhës Armene (dialekti Perëndimor dhe Lindor) me qëllim saktësimin e kuptimit të fjalëve të gjuhës Armene gjatë ballafaqimit me fjalët e gjuhës Shqipe në kapitullin ku bëhet fjalë për to.

Listimi i mëposhtëm i shërben qëndrimit korrekt ndaj sa më sipër është thënë.

*Հայերեն - Իտալերեն Բառարան; Կարինե Մկրտչյան, Երեվան, հեղինակային հրատարակչություն, 2010. (16 500 բառ եւ բառակապակցություն)*

Dizionario Armeno – Italiano; Karine Mkrtchyan, Yerevan, Edizione d’Autore, 2010. (16 500 parole e combinazioni delle paroli )

*Բառարան Հայերեն – Իտալերեն; Հ. ՎԱՀԱՆ ՎՐԴ ՕՀԱՆԵԱՆ, Վենետիկ – Ս. Ղազար 1996*

Dizionario Armeno – Italiano; P.Vahan Ohanian, Venezia – S. Lazzaro, 1966

*Իտալերեն - Հայերեն Համառոտ Բառարան; Երեվանի Համալսարանի Հրատարակչություն, Երեվան 2001 (մոտ 12 000 բառ)*

Dizionario Breve Italiano - Armeno; Edizione dell’ Universita di Erevan, Erevan 2001 (circa 12 000 voci)

*Անգլերեն - Հայերեն / Հայերեն – Անգլերեն Բառարան; կազմողներ: Սոնա Սեֆերյան, Լյուդմիլա Հովհաննիսյան, Աննա Խաչատրյան, Տաթևվիկ Քալաեջյան, Գայանե Գրիգորյան; Արեգ, Երեվան 2009 (շորջ 40 000 բառ եւ արտահայտություն)*

English – Armenian / Armenian – English Dictionary; compiled by: Sona Seferian, Ludmila Hovhannisian, Anna Khachatrian,

Tatevik Kalaejian, Gayane Grigorian; Areg, Yerevan 2009 (over 40 000 entries)

*Հայերեն – Անգլերեն Արդի Բառարան; Աշխատասիրեցին: Վեր Տիգրան Խնդրունի եւ Մարտիրոս Գուշագճեան; Հրատարակչատուն Կ. Տոնիկեան եւ Որդիք, Պեյրուք 1970, Երեվան 1992*

Armenian – English Modern Dictionary; by Rev. Dicran Khantrouni & Mardiros Koushadjian; G. Doniguan & Sons Publishing House, Beirut 1970, Yerevan 1992

Armenian – English / English – Armenian; Diana Aroutunian and Susanna Aroutunian; Hippocrene Books, New York

*Բուսերեն Հայերեն / Հայերեն Բուսերեն Բառարան; Լուսիկ Մաքսության, Մարիամ Կիրակոսյան, Սամվել Գասպարյան; Արեգ, Երեվան 2007 (շորջ 22 000 բառ)*

*Հայ-Բուսերեն Բառարան; Երկրորդ լրացրած հրատարակություն; կազմեցին եւ խմբագրեցին: պրոֆ. Ա.Ս. Կարիբյան, պրոֆ. Ե. Գ. Տեր Մինասյան, Մ. Ա. Գեվորգյան; Հայաստանի Պետական Հրատարակչություն, Երեվան 1960 (շորջ 40 000 բառ)*

Fjalor Rusisht – Shqip; Instituti i Shkencave i R.P. të Shqipërisë; Shtëpia botonjëse Shtetërore e Fjalorëve të Huaj dhe Nacionalë, Moskë – 1954 (rreth 25 000 fjalë)

Русско - Албанский Словарь; Институт Наук Республики Албании Государственное Издательство Иностранних и Национальных Словарей Москва – 1954 (25 000 слов)



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Piranjani, Berzh

Fjalor pellazgjik : shqipja dhe armenishtja motra  
apo kushërira?! : përmbledhje fjalësh të ngjashme  
/ Berzh Piranjani. – Tiranë : M & B, 2022

160 f. ; 14 x 21 cm.

ISBN 978-9928-353-65-8

1.Gjuha armene 2.Gjuha shqipe 3.Historia  
4.Fjalorë 5.Gjuhësi krahasuese

81 '374.8 -022.215 =18 =19

811.18 -112





Çmimi: 550 Lekë